



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 25 tetor 2012

**Ceremoni për ndarjen e shpërblimeve për konkursin për ese më
të mirë
“Pse është kull të jesh i vjetër?”
me rastin e Vitit evropian 2012
(Qendra Informative e BE-së)**

Fjalim

**Shkëlqesia e Tij, z. Aivo ORAV
Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian**

I nderuara Ministër Kralev,

Të nderuar nxënës, mësues,

Zonja dhe zotëri,

Është kënaqësi e madhe që Delegacioni i BE-së e organizon sot ceremoninë për dhënien të shpërblimeve për konkursin për ese më të mirë me titull shumë frymëzues “Pse është kull të jesh i vjetër?”, me rastin e Vitit evropian për plakje aktive dhe solidaritet midis gjeneratave.

Qëllimi i Vitit evropian 2012 është rritja e vetëdijes për kontributin që personat më të vjetër e japin në shoqëri. Viti synon ti inkurajoj politikë-bërësit dhe palët relevant të çdo niveli të ndërmarrin aktivitete me qëllim që të krijojnë mundësi më të mira për plakje aktive dhe përforcimin e solidaritetit midis gjeneratave.

Ideja pas këtij aktiviteti është të ndërmerren aktivitete të cilat do të krijojnë mundësi më të mira për plakje aktive dhe forcimin e solidaritetit midis bashkësive.

Plakja aktive do të thotë plakje me shëndet të mirë, me jetë të mirë, ndjenjë më të pavarur në jetën e përditshme dhe involvim më të madh si qytetar aktiv në shoqëri

Pa marrë parasysh sa je mi të vjetër, ne përsëri mund ta luajmë rolin tonë në shoqëri dhe të gëzojmë cilësi më të mirë të jetës. Sfidë është

ta shfrytëzojmë sa më shumë potencialin e madh që e kemi edhe në moshë më të avancuar. Viti synon ta promovoj plakjen aktive në tre sfera:

1. Punësim – të qëndrojnë në forcën e punës dhe ti ndajnë eksperiencat e tyre;
2. Pjesëmarrje në shoqëri – të vazhdojnë të kenë rol aktiv në shoqëri;
3. Promovimi i jetës së pavarur – të jetojnë jetë sa më të shëndoshtë dhe sa më të plotë.

Sfida për politikanët dhe palët kompetent do të jetë ti përmirësojnë mundësitë për plakje aktive në përgjithësi dhe për jetë të pavarur, në sferat siç janë punësimi, kujdesi shëndetësor, shërbimet sociale, mësimi i personave të rritur, puna vullnetare, vendbanimi, IT shërbimet dhe transporti.

Në procesin e përgatitjes të këtij viti, përveç aktiviteteve të tjera, ne e organizuam konkursin për ese më të mirë për nxënësit e shkollave të mesme, duke shpresuar se do ti frymëzojmë dhe do ti angazhojmë gjeneratat e reja të mendojnë se çfarë do të thotë të jesh i vjetër dhe cilat janë përfitimet të jesh në atë moshë me përvojë.

Dhe nuk kemi gabuar. Kemi pranuar shumë punime nga nxënësit me përmbajtje të ideve të cilat e tregojnë se lidhjet ndërmjet gjeneratave

ekzistojnë dhe qëndrojnë.

Juria, siç jam i informuar, ka pasur punë shumë të vështirë për zgjedhjen e fituesve. Të gjithë punimet janë të shkëlqyeshme dhe frymëzuese.

Në fund, dua ti përgëzoj të gjithë pjesëmarrësit në konkursin për ese më të mirë, si edhe ti shprehi mirënjohjen Ministrit Krlevski për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Ministrinë për arsim dhe shkencë.

Ju faleminderit për vëmendjen!